

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. contact@pallatirinise.com

www. pallatirinise.com

Nr. 11745

Dt. 09.07.2024

Në mbështetje të dispozitave të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, nenit 130 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë Tregtare dhe në bazë të Statutit të NPL Pallati i Rinisë sh.a., Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Pallati i Rinisë" sh.a. në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.07.2024, miratojnë këtë:

R R E G U L L O R E

PËR PENSIONIM TË PARAKOHSHËM TË PUNËTORËVE NË NPL PALLATI I RINISË SH.A

Neni 1

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për pensionimin e parakohshëm të punonjësve në NPL Pallati i Rinisë sh.a. (tutje: Ndërmarrja).
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjithë punonjësit e NPL Pallati i Rinisë sh.a. me rastin e pensionimit të parakohshëm.

Neni 2


Rastet për pensionim të parakohshëm

Punonjësit e NPL Pallati i Rinisë sh.a., mund të kërkojnë pensionimin e parakohshëm jo më shumë se dy (2) vjet para afatit të përcaktuar për pensionimin e tyre.

Neni 3

Procedura për pensionim të parakohshëm me kërkesë të punonjësit

1. Punonjësi që plotëson kushtet e parapara në nenin 2 të kësaj Rregulloreje duhet të plotësoj Formularin nr.1 (në tekstin e mëtejshëm kërkesën) për pensionim të parakohshëm, që është e bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.
2. Kërkesa, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet Njesisë së Burimeve Njërëzore, e cila do të verifikoj nëse plotësohen kushtet e parapara në nenin 2 të kësaj Rregullore.
3. Njësia e Burimeve Njërëzore ia dërgon kërkesën udhëheqësit të drejtpërdrejtë të punonjësit, për të dhënë pëlqimin.
4. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë shqyrton kërkesën, duke marrë parasysh:
 - 4.1. Rëndësinë e punës që kryhet nga punonjësi në kuadër të sektorit;
 - 4.2. Dallimin ndërmjet kostos së pagës dhe kompensimit të punonjësit që pensionohet dhe pagës së punonjësit që e zëvendëson atë;
 - 4.3. Planifikimin e personelit në sektorin e caktuar;



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com
Nr. _____ Dt. _____

4.4. Mundësinë e zëvendësimit adekuat dhe/apo mundësinë e kryerjes së detyrave të tij/saj nga radhët e punonjësve të tjerë.

5. Pas shqyrtimit të kërkesës, sipas paragrafit 4 të këtij neni, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i punonjësit që kërkon pensionim të parakohshëm jep mendimin e tij në afat prej 15 ditëve të punës, i cili i dërgohet Njesisë së Burimeve Njerëzore.
6. Pas marrjes së mendimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, Njësia e Burimeve Njerëzore kompletton lëndën e punonjësit që kërkon pension të parakohshëm dhe e dërgon lëndën tek Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e e Ndërmarrjes.
7. Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e i/e Ndërmarrjes shqyrton kërkesën dhe merr Vendim në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 4

Përmbajtja e Vendimit për pensionim të parakohshëm

1. Vendimi për aprovimin e kërkesës për pensionim të parakohshëm duhet të përmbaj:
 - 1.1. datën e pensionimit të parakohshëm për punonjësin;
 - 1.2. pagesën për pensionim të parakohshëm;
 - 1.3. obligimet e punonjësit ndaj Ndërmarrjes sipas dispozitave ligjore në fuqi;
2. Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e nxjerr Vendim në rastet e mosaprovimit të kërkesës,
3. Njësia e Burimeve Njerëzore do ta informojë punonjësin për vendimin e marrë nga Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e, në afat prej tre (3) ditëve të punës.
4. Kundër vendimit të Kryeshefit/es Ekzekutiv/e, punonjësi ka të drejtë ankese, në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes.

Neni 5


Pensionimi i parakohshëm me iniciativë të Ndërmarrjes

1. Pensionimi i parakohshëm me iniciativë të Ndërmarrjes mund të bëhet në këto raste:
 - 1.1 kur Ndërmarrja bën riorganizimin, shuarjes së pozitave;
 - 1.2 kur një e më shumë sektore bashkohen në një sektor;
 - 1.3 si masë disiplinore për pensionim të parakohshëm;
 - 1.4 kur vërtetohet nga organi përkatës se punonjësi është i/e paaftë të kryejë punën e tij për arsye shëndetësore;
2. Pensioni i parakohshëm i punonjësit sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet vetëm nëse punonjësi është jo më shumë se dy (2) vjet para moshës së pensionimit.

Neni 6

Njoftimi për pensionim të parakohshëm

1. Ndërmarrja – Njësia e Burimeve Njerëzore në pajtim me paragrafin 1 të nenit 5 të kësaj Rregulloreje



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com
Nr. _____ Dt. _____

- duhet t'i njoftoj punonjësit 1 (një) muaj para datës së pensionimit të parakohshëm.
2. Në rastin e pensionimit të parakohshëm që është pasojë e masës disiplinore, punonjësi njoftohet me rastin e shqiptimit të masës.
 3. Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 5 të kësaj Rregullore, do t'i identifikojë punonjësit të cilët kanë edhe 2 (dy) vite para moshës së pensionimit.
 4. Në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, Njësia e Burimeve Njerëzore i dërgon Kryeshefit/es Ekzekutiv/e të dhënat e punonjësve që kanë arritur moshën e pensionimit të parakohshëm dhe rastet kur punonjësi është vlerësuar nga organi kompetent i paaftë për kryerjen e punës për arsye shëndetësore.
 5. Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e e Ndërmarrjes do të shqyrtoj të dhënat e dërguara nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe do të vendosë për cdo rast me vendim për pensionimin e parakohshëm të punonjësit.
 6. Njësia e Burimeve Njerëzore do t'i informojë të gjithë punonjësit me vendimin e marrë nga Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e e Ndërmarrjes për pensionimin e parakohshëm.

Neni 7

Kompensimi për pensionim të parakohshëm

1. Punonjësi që pensionohet para kohe sipas dispozitave të kësaj Rregullore, në bazë të kërkesës së tij, të Ndërmarrjes apo si pasojë e masës disiplinore, Ndërmarrja do t'i paguajë shumën mujore prej 70% të pagës së fundit bazë të punonjësit për periudhën e mbetur deri në moshën e pensionimit të vjetërsisë.
2. Kur punonjësi i pensionuar para kohe sipas kësaj Rregullore arrin moshën e pensionimit gëzon të drejtën e pagesës së pensionimit.

Neni 8


Plotësim ndryshimi

Plotësim ndryshimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet me propozim të Kryeshefit/es Ekzekutiv/e, anëtarëve të bordit të drejtorëve si dhe departamenteve të ndryshme brenda Ndërmarrjes.

Neni 9

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje, obligohet Kryeshefi/ja Ekzekutive e Ndërmarrjes, Sektori i Financave/Kontabilitetit dhe Sektori i Burimeve Njerëzore/Administratës.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com
Nr. _____ Dt. _____

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të NPL Pallati i Rinisë sh.a.

BORDI I DREJTORËVE:

Ariana Pireva, Kryesuese _____

Gani Sopi, Anëtar _____

Vjosa Rrahmani, Anëtare _____

Shuajb Mehmeti, Anëtar _____

Mrikë Gashi Macula, Anëtare _____

